

VENDIM
Nr. 42, datë 21.1.2026

**PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
EKONOMISË MALORE NË BASHKINË TEPELENË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Tepelenë të zonave, si më poshtë vijon:

a) Zona nr. 1, pjesë e njësisë administrative Kurvelesh, me sipërfaqe 9673 (nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

b) Zona nr. 2, pjesë e njësisë administrative Lopës, me sipërfaqe 3741 (tre mijë e shtatëqind e dyzet e një) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

c) Zona nr. 3, pjesë e njësisë administrative Qendër-Tepelenë, me sipërfaqe 19291 (nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.


4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN VENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE NR.3 (QENDER TEPELENE) - SHK. 1:100 000

SIPERFAQJA=19291 HA



GRUPI I PUNËS

- 1-Spiro Kora
- 2-Gezim Shehu
- 3-Ervin Panidha
- 4-Avni Abedini
- 5-Leonidha Shumeli
- 6-Florenc Korca

MIRATOHET

KRYETAR
NË
DETYRË
E
BASHKISË
TEPELENË

JULINDA KARTERI


PLAN VENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE NR.1 (KURVELESH) - SHK. 1:100 000 SIP=9673 HA



Planvendosje Zona 1.

<https://geoportal.asig.gov.al>

Data e Printimit: 05.11.2025.



SHK. 1:100000



Planvendosje Zona 1, S= 9673 HA.

<https://geoportal.asig.gov.al>

Data e Printimit: 05.11.2025

GRUPI I PUNËS

1-SPIRO KORA

2-GËZIM SHEHU

3-ERVIN PANIDHA

4-AVNI ABEDINI

5- SHABAN LOÇI

MIRATOHET



KRYETARE NË DETYRË E BASHKISË TEPELENË

JULINDA KARTERI



PLAN VENDOSJE E ZONES ZHVELLIMORE NR.2 (LOPES) - SHK. 1:100 000

SIPERFAQJA=3741 HA



GRUPI I PUNËS

1-SPIRO KORA

2-GËZIM SHEHU

3-ERVIN PANIDHA

4-AVNI ABEDINI

5- ARTUR ORMËNI

MIRATOHET

KRYETARE NË DETYRË E BASHKISË TEPELENË

JULINDA KARTERI

